



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 7 MARS 2013**

**SA SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 7. MARTA 2013. GODINE**

**MARS - MART
2013**

Rendi i ditës

1. Shënimi i 15-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Dnevni red

1. Obeležavanje 15-te Godišnjice Epopeje Oslobođilačke vojske Kosova

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga,
I nderuari kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
E nderuara Familje Jashari.
I nderuar Rifat Jashari,
Të nderuara familje të dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,
Të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare në Kosovë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Mirë se keni ardhur në seancën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të thirrur me rastin e shënimit të 15-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

(Intonimi i Himnit të Republikës së Kosovës)

E ftoj përfaqësuesin e propozuesit të thirrjes së kësaj seance, deputetin Rexhep Selimi, ta marrë fjalën.

REXHEP SELIMI: E nderuara Familje Jashari,
Të nderuar familjarë të dëshmorëve, bashkëqytetarë, invalidë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,
Zonja dhe zotërinj deputetë,
Të nderuar mysafirë në seancë,
Të dashur qytetarë dhe bashkëkombës,
Ky Kuvend si institucion dhe ne si deputetë e kemi nderin e veçantë që sot në këtë seancë solemne parlamentare t'i përkulemi me respekt veprës së madhe të Komandantit Legjendar Adem Jashari, t'i përkulemi me respekt të veçantë veprës heroike të Familjes Jashari dhe gjithë atyre që ranë para 15 vjetësh në Epopenë e Jasharëve, në Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Prekaz, më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998.

Sot, në 15-vjetorin e kësaj ngjarjeje të përmasave legjendare dhe të sakrificës deri në flijim për lirinë e vendit, le të përpiqemi edhe një herë ta kujtojmë porosinë e atyre që ranë të vetëdijshëm se mbi rëniet e tyre do të ringritej liria e kombit.

Kuvendi i Kosovës, sot po e bën një detyrë, detyrë e cila i takoi ta bënte dhe duhet ta bëjë çdo vit, gjithmonë dhe pandërprerë, të përkulet para gjakut të dëshmorëve të atdheut dhe para sakrificës të të rënëve për Liri:

Shaban Murat Jashari, Zahide Jashari, Adem Jashari, Hamëz Jashari, Zarife Jashari, Hidajete Jashari, Valdete Jashari, Igball Jashari, Igballe Jashari, Feride Jashari, Selvete Jashari, Afete Jashari, Besim Jashari, Lirie Jashari, Blerim Jashari, Fatime Jashari, Blerinë Jashari, Adile Jashari, Fitim Jashari, Kushtrim Jashari, Salë Jashari, Hamit Jashari, Osman Geci, Bahtije Jashari, Abdullah Jashari, Blerim Zenë Jashari, Bujar Jashari, Qazim Jashari, Nazmi Jashari, Sinan Jashari, Ali Jashari, Beqir Jashari, Halil

Jashari, Sherif Jashari, Elheme Jashari, Murtez Jashari, Faik Jashari, Qerim Jashari, Kajta Jashari, Hamide Jashari, Shahin Jashari, Sadik Jashari, Hafije Jashari, Hamdi Jashari, Elfije Jashari, Fatime Jashari, Ramiz Jashari, Mihrije Jashari, Sabrije Jashari, Hanife Jashari, Smajl Jashari, Ukshin Jashari, Hajrie Jashari, Ajvaz Jashari, si dhe bashkë me Jasharët: Isa Halili, Fatime Bazaj dhe Smajl Bazaj.

Këta nuk janë veç emra e mbiemra, por letërnjoftim i sakrificës së popullit shqiptar për Liri.

Zonja dhe zotërinj,
Përveçse sot e kujtojmë Epopenë e UÇK-së, sot është edhe Dita e Mësuesit. Sot është 7 Marsi. Sot, edhe më shumë se dje, mësuesi është Shaban Jashari.

Shaban Jashari nuk ishte thjesht babai i Ademit e Hamzës, por ai ishte edhe mësues. I mësonte fëmijët e Prekazit, por e mësonte edhe Ademin e Hamzën. U tregonte fëmijëve për historinë e popullit shqiptar dhe për figurat e lavdishme të tij. Për vuajtjet e sakrificat, por edhe për fitoret e sukseset e kombit tonë.

Para 15 vjetëve, baba dhe mësuesi Shaban iu bashkua këtyre figurave të lavdishme të kombit. Ai iu bashkua atyre për të cilët na tregonte e na mësonte.

Hamza dhe Ademi ishin nxënës të tij, që tash janë bërë mësues të idealit kombëtar për të gjithë ne dhe për ata që vijnë pas nesh.

Pra, sot ia urojmë 7 Marsin mësuesit të Kombit, Shaban Jashari.

Të nderuar të pranishëm,
Popujt dhe kombet i kanë historitë e tyre. Popujt dhe kombet luftuan dhe vazhdojnë të luftojnë ende për liri. Në historinë e tyre, kombet kanë bërë sakrifica të mëdha për liri. Por, nuk ka komb në botë ta ketë një Adem Jashar, ashtu siç e ka kombi ynë. Nuk ka komb në botë ta ketë një familje Jashari, ashtu siç e ka kombi ynë.

Një diplomat, kur e pa Prekazin, pati thënë: “Po të ekzistonte çmimi Nobel për luftë, ai do t’i takonte Adem Jasharit...”.

Ndoshta nuk ka çmim Nobel për luftë, por çmimin e lirisë, çmimin e luftës për liri, Adem Jashari ia dhuroi kombit të vet.

Sot, ne nuk mund të flisim për luftën për liri pa Adem Jasharin, por as s’mund ta paramendonim Adem Jasharin pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ishte veç ushtria e tij, por edhe lufta e tij. Le të ruhet dhe të nderohet UÇK-ja si vlerë historike e kombit.

Aty ku ruhet sot UÇK-ja si vlerë e kombit qëndron edhe porosia e Jasharëve, porosia e Adem Jasharit. UÇK-ja si vlerë dhe histori nuk mund të shihet ndaras nga porosia e Adem Jasharit për liri dhe bashkim kombëtar.

Të shumtë janë ata që i kemi dëgjuar duke thënë se politika duhet të jetë realiste. E po ashtu, të shumta janë edhe këmbënguljet se iluzionet idealiste janë provuar si të rrezikshme dhe të përgjakshme.

Por, çfarë është, në të vërtetë, realja për vetë politikën? Realja është Historia. Realja është bërja konkrete e betejës dhe mohimi i shtypjes.

Po si bëhet e mundur ta njohësh dhe ta kuptosh Historinë? Mund vetëm nëse i njohim ligjësitë e historisë, ligjësitë e mëdha të bërjes, pra të realizimit.

Ata e bënë. Ata e realizuan Historinë.

Çdo akt tjetër, pos tyre, ose mund të qëndrojë në linjë me këtë bërje historie, ose në të kundërtën e saj. Historia nuk njeh akte të mesme. Realiteti i prodhuar prej tyre mund të jetë, ose veç historia, ose edhe realiteti ynë.

Këto 15 vjet kemi dëgjuar shumë shpesh të flitet për ngjarje historike, për vendime historike, për arritje historike. Secila prej tyre e ka provën e vërtetësisë, e ajo është përputhja, ose jo me realen e prodhuar nga akti historik që mban shenjën Jashari.

Le ta rikujtojmë edhe një herë sot dhe gjithmonë në të ardhmen se jeta e Jasharëve dhe dëshmorëve të lirisë ishte mision, kurse rënia e tyre porosi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Thaçi, për një fjalë rasti.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:

E nderuara presidente e Republikës së Kosovës, zonja Jahjaga,

I nderuari kryeparlamentar, zoti Krasniqi,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara familje Jashari,

Të nderuara të gjitha familje të Dëshmorëve të Kombit,

Të nderuar mysafirë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kam nderin dhe privilegjin e veçantë që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të ju drejtohem me një fjalë rasti në përvjetorin e pesëmbëdhjetë të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ky manifestim me të drejtë e mban emrin Epope, sepse shënon sakrificën supreme të Jasharëve, që sublimuan vetëdijen politike dhe shpirtin liridashës të të gjitha kohëve për Kosovën e lirë, të pavarur dhe moderne.

Tri ditët e Epopesë sintetizuan rrugën e gjatë historike të qëndresës dhe të luftërave të drejta të brezave për çlirimin e Kosovës nga okupimi shekullor.

Gjatë tri ditëve të Epopesë së UÇK-së u sfidua historia dymijëvjeçare e civilizimit shqiptar. U krijua Epopeja e Lirisë.

Në themelet e saj ishte Familja Jashari, Komandanti Adem Jashari, Komandant Hamza, gratë, djemtë, fëmijët, një lagje e tërë.

Historia e Kosovë po përballej me makinën shekullore të sundimit të Kosovës. Dëshmorët e lirisë u flijuan për ëndrrën e të gjithë brezave, çlirimin e Kosovës.

Rënia e Jasharëve, në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari, hapi kapitullin më të madh të zgjerimit dhe rritjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ushtria Çlirimtare Kosovës, me një bazë të gjerë popullore, ishte niveli më i lartë i organizimit politiko-ushtarak, që kishte prodhuar ndonjëherë lëvizja atdhetare e Kosovës.

Shumë shpejt, Ushtria Çlirimtare e Kosovës që nga themelimi do të bëhej projekti më serioz që artikuloi kërkesat politike dhe interesat strategjike të Kosovës në periudhën 1992-1999.

Mbi parimin e luftës së drejtë dhe çlirimtare, me vizionin perëndimor, me objektivat e qarta, Ushtria Çlirimtare e Kosovës arriti përkrahjen e faktorit ndërkombëtar, duke u bërë zëri kryesor dhe udhëheqës në Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë.

Në Rambuje, Kosova për herë të parë dhe përfundimisht, arriti marrëveshjen e partneritetit të plotë politik dhe ushtarak me botën perëndimore.

UÇK-ja dhe rezistenca gjithëqytetare e Kosovës, padëgjueshmëria politike e tyre ndaj Serbisë, rezistenca 1990-1998-1999, bëri që të jemi të bashkuar në Rambuje dhe të fitojmë.

Rambujeja solli bombardimet e NATO-s dhe çlirimin definitiv të Kosovës.

As makineria e rëndë serbe, as doktrinat e tejkaluara ushtarake, as terrori dhe spastrimi etnik nuk e mposhtën qytetarin liridashës të Kosovës.

Prandaj, sot, me krenarinë më të madhe, themi me plot të drejtë se çdo qytetar i Republikës së Kosovës duhet të ndihet mirë dhe krenar me çlirimin e Kosovës, duhet të ndihet mirë dhe krenar me kontributin e tij për lirinë e Kosovës.

Shteti i Kosovës do ta nderojë këtë sakrificë gjithmonë dhe do ta nderojë sakrificën e çdo shqiptari kudo që jeton. Do ta nderojë sakrificën e çdo qytetari të Kosovës në Diasporë, që e ndau edhe kafshatën e gojës për lirinë dhe çlirimin e Kosovës. Çlirimtarë janë të gjithë kosovarët, të gjithë qytetarët e Kosovës, të gjithë shqiptarët.

Dhe, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk u mposht, sepse ajo armë kryesore e kishte shprehjen e vullnetit të qytetarëve të Kosovës, krijimin e aleancës politike properëndimore, depërtimin e së vërtetës në opinionin publik ndërkombëtar.

Në radhët e saj do të angazhoheshin me vullnet dhe përkushtim të jashtëzakonshëm bij dhe bija të këtij vendi, që kishin pritur me vite për t'u rreshtuar në radhët e një ushtrie autoktone, të dalë nga gjiri i popullit.

Në radhët e saj do të vinin djem dhe vajza nga Diaspora dhe nga të gjitha trevat shqiptare. Në shërbim të luftës së drejtë do të shkrihet pasuria, mudi, djersa dhe gjaku.

Në periudhën 1990-1999, rezistenca e qytetarëve të Kosovës, rezistenca politike dhe ushtarake, padëgjueshmëria e plotë qytetare kundër Serbisë, angazhimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i dhuroi lirisë së vendit tonë gjakun e rreth dymijë pjesëtarëve të saj.

Zonja dhe zotërinj,

Ushtria Çlirimtare e Kosovës krijoi parakushtet për ta vënë në lëvizje mekanizmin më të fuqishëm ushtarak botëror, Aleancën Veriatlantike, NATO-n.

Me të drejtë, Ushtria Çlirimtare të Kosovës ka hyrë në analet historisë si guerilja, si lëvizja çlirimtare më e suksesshme e shekullit njëzet, dhe kjo duhet të na bëjë krenarë të gjithëve, pa dallim.

Zonja dhe zotërinj,

Epopeja e Lirisë nuk mund të mendohet pa Epopenë e UÇK-së, pa sakrificën, pa gjakun dhe sakrificën e të gjithë dëshmorëve të lirisë.

Prandaj, sot, me respekt të lartë shtetëror dhe krenari qytetare e kombëtare përulemi para guximit të dëshmorëve të lirisë, para veteranëve të luftës, para invalidëve, para familjeve të dëshmorëve dhe sakrificës së çdo qytetari të Republikës së Kosovës.

Përulemi para të gjithë atyre që u flijuan heroikisht për lirinë e Kosovës. E liria e Kosovës i ka rrënjët në rënien e tyre. Liria e Kosovës e ka në themel rënien e komandantëve: Zahir Pajaziti, Luan dhe Shkëlzen Haradinaj, Bekim Berisha, Fehmi e Xhevë Lladrovci, Ilaz Kodra, Mujë Krasniqi, Ahmet Kaçiku, Sali Çeku, Remzi Ademi, Agim Ramadani dhe shumë komandantëve, ushtarëve dhe drejtuesve tjerë të luftës çlirimtare.

Pra, UÇK-ja vërtet u bë legjendë. Sakrifika e qytetarëve të Kosovës është legjendare.

Zonja dhe zotërinj,

15 vjet pas Epopesë, Kosova është tregim i shtetndërtimit të suksesshëm, sepse, pas takimeve në Vjenë, si politikë e Kosovës përsëri e ndërtuam partneritetin e ngushtë me bashkësinë ndërkombëtare, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n.

Dhe ne, të zgjedhurit e popullit të Kosovës, më 17 shkurt 2008, e shpallëm Kosovën të pavarur dhe sovranë.

Kosova e ka kaluar me sukses fazën e tranzicionit, duke e dëshmuar kulturën demokratike, politikën paqësore dhe kultivimin e vlerave euro-perëndimore. Sot, shteti i Kosovës është njohur ndërkombëtarisht nga afro 100 shtete.

Shteti ynë po konsolidohet dhe po forcohet. Ne, para pak muajsh, me një vlerësim të lartë ndërkombëtar, e përmbyllëm edhe procesin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë.

Prandaj, dëshiroj edhe një herë të ju falënderoj të gjithëve për këtë punë të përbashkët e unike të të gjithë spektrit politik të Kosovës, të shtetit të Kosovës dhe vullnetit të qytetarëve të vendit.

15 vjet pas Epopesë së UÇK-së, Kosova është duke i vazhduar përpjekjet për përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë, për ngritjen e infrastrukturës moderne, për reformimin e edukimit dhe për ngritjen e kapaciteteve për të qenë vend konkurrent në rajon dhe në botë.

Kosova do të vazhdojë me vendosmëri të jetë e përgjegjshme në rrugën e saj euroatlantike, si shtet i gjithë qytetarëve të saj, në të cilin liria, barazia dhe sundimi i ligjit janë parime themelore.

Kosova do të vazhdojë të jetë faktor stabiliteti, paqeje dhe shembull i fqinjësisë së mirë në rajon dhe më gjerë, duke e justifikuar angazhimin e miqve dhe përkrahjen e tyre të vazhdueshme në drejtim të afirmimit të shtetit tonë në arenën ndërkombëtare.

Janë ditët e Epopesë së UÇK-së, prandaj në emër të Qeverisë së Kosovës, të qytetarëve të Kosovës, i falënderojmë për mbështetjen e vazhdueshme të jashtëzakonshme vendet e Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n, por edhe për mbështetjen e vazhdueshme që po ia japin Kosovës edhe sot, edhe në këtë proces të ri të konsolidimit dhe shtetndërtimit të saj, të ndërtimit të fqinjësisë së mirë me të gjithë vendet e rajonit dhe perspektivës së sigurt euroatlantike të vendit tonë, të shtetit tonë të ri demokratik, shtetit tonë evropian, për t'u anëtarësuar sa më shpejt në NATO, në Bashkimin Evropian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Zonja dhe zotërinj,

Duke iu falënderuar përpjekjeve dhe idealeve të brezave të tërë, duke iu falënderuar heroizmit të ditëve Epopesë së UÇK-së, fundi i shekullit njëzet ishte fillimi i lirisë së Kosovës.

Shekulli njëzet pa dyshim është shekulli i Kosovës evropiane, i Kosovës së integruar në NATO, në Bashkimin Evropian dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Lavdi Epopesë së UÇK-së!

Lavdi Dëshmorëve të Kombit! Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar qytetarë,
Të nderuar të pranishëm,
Më lejoni që në këtë përvjetor të Epopesë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të ju drejtohem, në emër të Kuvendit, me një fjalë rasti.

Zonja dhe zotërinj,
Çasti që na mblodhi sot në këtë seancë nderimi e përkujtimi i detyrohet një ngjarjeje, sigurisht të madhe, që kur e kur u quajt betejë, kur e kur u quajt luftë, kur e kur epope. Në cilindo variant që ta marrim, nuk mungojnë përcaktorët: Prekazi - Adem Jashari - Jasharët - Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Si kur themi Beteja e Prekazit, si kur themi Lufta e Prekazit, po ashtu edhe kur themi Epopeja e Prekazit, Epopeja e Adem Jasharit, apo Epopeja e UÇK-së, në kujtesën tonë rikthehen pesë, gjashtë dhe shtatë marsi i vitit 1998 - hapja e faqes më të re të historisë, hapja e epokës së re, që na e solli pavarësinë, sovranitetin, demokracinë, të formalizuar në Kuvendin e Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Ato qenë tri ditë e tri net. “Na i ka ra mjegulla Bunës, për tri ditë e për tri net”. Kështu nis Legjenda e Rozafatit. E shihni se filli i legjendarizmit të ngjarjes nuk është trill i individëve, as glorifikim i shpifur i njerëzve mendjelehtë, po një ardhje përtej coincidence, drejtpërdrejt nga bota e legjendave. As më shumë, e as më pak: tri ditë e tri net, tymi i barotit e kishte mbuluar Prekazin, ankthi Drenicën, e heshtja shqiptarët. Qëllimi i tymit ishte përhapja e frikës, por ndodhi e kundërta, shqiptarët e përqaftuan guximin për liri e pavarësi; bota demokratike na mbështeti në këtë rrugë. E para, flijimit për liri i përkulemi; e dyta, shtetet demokratike i falënderojmë nga zemra.

Nga pozicioni i sotëm bëhet i pashmangshëm krahasimi, si pyetje dhe si dilemë, me pesëmbëdhjetë vjet më parë: Ku ishim, e ku jemi? Si ishim, e si jemi? Si ishim, e si jemi? Çka kemi realizuar dhe çka na mbetet të realizojmë nga ëndrrat idealiste për shtet ligjor, të zhvilluar e të përparuar, për çka vendi ynë afron shumë paradispozita, njerëzore e natyrore? A po i shfrytëzojmë më së miri ato?

E para, që dihet tashmë, fakti i robërimit të Kosovës ishte i njohur nga të gjitha shtresat shoqërore dhe nga pjesëtarët e çdo moshe. Kishte pothuajse një dekadë, nga e nëntëdhjeta e shekullit të kaluar, që nxënësit e studentët ishin përzënë nga bankat e shkollave të tyre e nga auditorët e fakulteteve; punëtorët qenë dëbuar nga puna në të gjithë sektorët shoqërorë, shtetërorë e publikë; spitalet, administrata e ndërmarrjet prodhuese ishin vënë nën administrim të dhunshëm; ishte suprimuar edhe ajo e ashtuquajtura autonomi; mediet elektronike dhe të shkruara në gjuhën shqipe qenë mbyllur. Të thuash, siç edhe ishte thënë atëherë, kishim të bënim me një segregacion, më është dukur atëherë e më duket edhe tani se nuk ishte tjetër veçse një eufemizëm. Shenjat dhe parashenjat flasin ndryshe. Për atë ndryshe, kishte kohë që Lëvizja Kombëtare Çlirimtare kishte paralajmëruar për dekada të tëra. Kemi pritur shumë nga çlirimi dhe nga pavarësia. Çka kemi realizuar nga pritjet e mëdha? Një bilanc duhet ta bëjmë. Gjeneratat e reja, kryeshpresë të tyre duhet ta kenë Kosovën evropiane. Kjo varet nga ne, sa jemi mishëruar me ato vlera që i ndoqëm gjatë gjithë historisë sonë për t’ua ushqyer shpresën dhe kthyer atë në besim?

Ju e dini se që nga tetëdhjetenjëta, djemtë shqiptarë ndiqeshin, burgoseshin e disa edhe ktheheshin nga armata serbe, e quajtur jugosllave, në arkivole të metalta të blombuara, me të vetmin kumt ogurzi: Ka kryer vetëvrasje!

Këto ishin paravane të pistës së dëbimit të shqiptarëve nga Kosova, tezë e përgatitur në institucione diabolike të mendjes, si SANU - Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve. Dhe, në vitet e '90-ta kishin arritur të largohen nga Kosova mbi 400 000 veta.

Më lejoni të jua kujtoj mendjendriturin Fan Noli, i cili qysh në periudhën e ashtuquajtur të Reformës Agrare dhe të rikolonizimit të Kosovës, e ngrinte zërin e protestës tek shkruante, sipas kujtesës sime: Një tragjedi me tri 'ç', duke iu referuar Kosovës: ç'thurje, ç'bërje, ç'dukje. Kjo ishte politika e programuar serbe e kohës, e cila u ndoq me fanatizëm deri në luftën e fundit.

Një gjendje e këtillë u shfaq si kokë hidre mu në të hyrë të të nëntëdhjetave. Dhe, qëlloni që mu në atë kohë po ktheheshin nga burgjet "kontingjentet e irredentës" - siç quheshin atdhetarët shqiptarë me gjuhën e pushtuesve dhe të sahanlpirësve të tyre, prej aty ku kishin vuajtur mbi 250 shekuj burg. Po ktheheshin, veçse jo në liri, por nga burgu i vogël në burgun e madh - Kosovë.

Me logjikën e mësuar nga shkrimtari i madh spanjoll, Servantes, autori i kryeveprës letrare "Don Kishoti i Mançes", i cili, disa shekuj më parë thoshte: "Duhet mësuar shkencën e durimit", kishte provuar ta praktikonte Gandi në Indi. Vjelë nga librat, një rezistencë të konvertuar paqësore kishte provuar edhe Lëvizja Alternative në Kosovë, e udhëhequr nga intelektualit e letrari Ibrahim Rugova, në vitet e '90-ta.

Duke mos parë shpresë e as dritë në fund të tunelit, një burrë Drenice, Adem Jashari, i kthehet një burimi tjetër, në dukje atavist, por në esencë vetëmohues deri në përmbarrim. Nuk bëj asnjë zbulim po të ju them se në mendjen e tij zgjohen një nga një heronjtë e lavdisë e të krenarisë kombëtare, por vetidentifikimin më të pranueshëm e gjen te Bajo e Çerçiz Topulli, te prijësit e çetave të lirisë në të hyrë të shekullit XX që kulmuan në Kryengritjen Shqiptare të vitit 1912, të udhëhequr nga Hasan Prishtina, të kurorëzuar në pavarësinë e formalizuar nga Kuvendi i mbledhur në Vlorë nga Ismail Qemali, më 28 nëntor 1912.

Për më afër akoma, bëmat e trimave të Drenicës, të Kosovës e të shqiptarisë që i ka dëgjuar që nga fëmijëria në odën e Babë Shabanit, aty është folur e kënduar për Ahmet Delinë, Azem Bejtën e Shotën, për Shaban Polluzhën e Mehmet Gradicën, për Ramiz Cërnicanë e Rifat Berishën, për flamurtarin Fazli Greiçevci e qëndrestarin Adem Demaçin, për Kadri Zekën e Jusuf Gërvallën, për Rexhep Malën e Nuhi Berishën. Është krejt i logjikshëm dhe aspak ritual betimi i tij me Babë Shabanin e me të vëllanë Hamzën, te varri i bashkëfshatarit, Tahir Meha. Tash betimi nuk parakupton hakmarrje fisi e kanuni, por kauzë kombëtare: Liri për Atdheun.

Ai i ka nisur aksionet e para çlirimtare, e ka provuar rrethimin dhe sulmin e parë në shtëpinë e babës, e ka mbyllur me sukses edhe betejën e parë në Vojnikë, është mbrojtur

suksesshëm nga sulmi diversant në 21 e 22 janarit të vitit 1998, e ka parë nga afër tragjedinë e Çirezit e Likoshanit, ku edhe vetë është përballur me helikopterin, pak ditë para Përballjes së Madhe të Marsit.

Adem Jashari ka shkelur mbi të dyzetat e moshës, pikërisht moshë burri. Doktrinat religjioze flasin për shenjtërimin një herë në dyzet vjet. Pa dashur të merrem me to, them se ai e dha shenjën e vet në gjithë Kosovën. Jo ikje e fshehje, por luftë deri në vdekje për Atdheun e lirë, për shqiptarizmen si fe, si traditë e kulturë shqiptare, pse jo edhe evropiane.

Ata që e kanë njohur, e quaj edhe veten njeri me fat që e kam njohur, thonë se aureola prej prijësi i rrinte mbi ballë, sado që kurrë nuk u deklarua e nuk u mburr as për grada, e as për ofiqe e për emër. Ai u mburr vetëm me Atdheun, me Shqipërinë e shqiptarinë. Me atë që kishte prodhuar breza shqiptarësh, para dhe pas Kastriotit - Kryeheroit Skënderbe. Kjo aureolë, mbase bëri që Arif Manxholli, një mik i Shaban Jasharit, në vitin 19991, t'i thoshte atij: "Ruajeni këtë djalë se ka me iu dashtë vendit!", që sot na vjen si profeci. Nëse nuk është profeci, atëherë çka e shtyri Arif Manxhollin ta shqiptonte profecinë e tij: "Ruajeni këtë djalë se ka me iu dashtë vendit!" Unë jam i bindur se Arif Manxholli në aureolën e Adem Jasharit e pa një të veçantë që ne vdektarët e tjerë nuk e vërejmë dot.

Emri i tij dhe kulla e tij nuk kishin të bënin me folklorizmin, por me akademinë e atdhedashurisë, ku Legjendari ynë e mësoi vendosmërinë e gatishmërinë për t'u përballur me të keqen, me robëruesin, me vdekjen, pavarësisht tagrit e çmimit. Si i tillë, ai u bë pritësi dhe mbështetësi i të gjithë luftëtarëve anekënd Kosovës e trojeve të tjera etnike shqiptare. Duke qenë fjalëpak e punëshumë, fjalia e tij u bë proverbiale: "Tanë ka pak e bahet boll!". Madje, midis atij terri pa shpresë e shteg, ai e gjeti: shpresën, shtegun dhe rrugën që na i dhuruan fitoret që i kemi sot.

Me një fjalë, ky ishte sfondi ku ishim e si ishim me të hyrë të marsit të nëntëdhjetetës.

Adem Jashari ra me mbi pesëdhjetë veta, familjarë e të afërm. Rënie që e mobilizoi një popull të tërë në luftën për liri.

Pushtuesit, të vetëdijshtë për përmasën e tij, provuan që duke e ekspozuar trupin e vrarë në TV, ta shuanin edhe mundësinë e fundit të mitizimit të tij, ta shuanin dashurinë për lirinë.

Ata, armiqtë, të mbushur me urrejtje e epshe prej bishe, nuk e kapnin dot sekretin e lirisë që vjen e shndërrohet në mesazh, në flamur, në himn e himnizim atdhedashës.

Trupi i tij, mu në krahë e kishte shpellën e predhës së mortajës antitank të armikut. Asnjë propagandë, çfarëdo qoftë ajo, nuk e vret dot amën e lindjes së legjendës, siç nuk e vrau legjendën për Adem Jasharin. Legjenda dhe lavdia as nuk vriten, as nuk fitohen tinëzisht, as nuk shpërndahen te vdektarët si dhuratë, ndonëse këta shpesh e kërkojnë. Legjenda e lavdia i përkasin vetëm atij që i meriton, një i tillë i meritueshëm pa dyshim që ishte vetëm Adem Jashari, ai që i pari ia hapi krahët e shqiptonjës armikut.

Legjendari Adem Jashari nuk njihet pleqëri, përkundrazi ai mbeti djalzotësi dylzetvjeçar, i përjetshëm i këtij populli me rrënjë të thella antike.

Epo, ku jemi e si jemi sot, pas pesëmbëdhjetë vjetëve?

Po, jetës sonë i është kthyer ritmi, ose më saktë bioritmi.

E dimë ç'kuptim ka dita dhe nata në liri, e dimë se ç'është orari i punës, e i mësimi, fatkeqësisht jo të gjithë dhe jo për të gjithë.

E dimë se Kosova me 17 shkurt të vitit 2008 e ka shpallur pavarësinë si shtet i pavarur, sovran e demokratik.

E dimë gjendjen e familjarëve të të pagjeturve, prehje në qetësi e paqe shpirtit të atyre që s'janë, po e mori vesh bota gjëmën: Ku është parë të vriten qytetarët e pafajshëm e të paarmatosur në shtëpi e në oborr e të degdisen kufomat me transportin e madh prej qindra e mijëra kilometrash në hapësirat e pushtuesit, e në valët e Danubit.

E dimë, e s'e dimë.

E dimë se më pesë, gjashtë e shtatë mars, në nderim të Epopesë së Prekazit, sot në gjithë Kosovën organizohen manifestime përkujtimore me patronat qeverie a qytetarie;

E dimë se bëhen homazhe të varrezat, akademi përkujtimore, koncerte e ndezje zjarresh për ta përkujtuar zjarrin e ndezur nga legjendari Adem Jashari.

E dimë, po nuk e di a e dimë saktësisht se, siç thoshte poeti i ndjerë Azem Shkrelë në një varg: "bajramcurremi maleve", nuk e di a të të mësojmë ndonjëherë të 'ademjasharemi' fushave, maleve, fshatrave e qyteteve të Kosovës për t'i dhënë kuptim jetës sonë në liri e pavarësi?

Ky fenomen sot, besoj, as nesër nuk na e kërkon çmimin e jetës, veç të angazhimit me ndershmëri.

Koha jonë kërkon shumë pak haraç nga ne: kërkon nderin dhe ndërgjegjen prej qytetari e pushtetari, prej nxënësi e studenti, prej partiaku e intelektual, prej ndërmarrësi e politikani, prej artisti e shkrimtari.

Të 'ademjasharemi' në paqe! Ja, vetëm kaq na kërkon legjenda, vetëm kaq na kërkon jeta, vetëm kaq na kërkon Kosova e pavarur.

Të 'shabanjasharemi', jo vetëm në Ditën e Mësuesit për t'i edukuar brezat me atdhedashurinë, me shqiptarizmin dhe evropianizmin e rilindësve tanë mendjendritur, edukatë që është duke na munguar në një masë. Shkolla jonë duhet të na kthejë edukimin tradicional kombëtar e evropian.

Me shpresë e besim ta lajmë këtë borxh, borxhin e dalzotësit në paqe. Kaq pak kërkon atdheu ynë sot nga ne.

Sot kur kujtoj ngjarjen e para pesëmbëdhjetë vjetëve në Prekazin e Adem Jasharit, më vjen të them nga thellësia e zemrës:

Lavdi e përjetshme Kryekomandantit Legjendar Adem Jashari!

Lavdi e përjetshme të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës! Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Mysafirë të nderuar dhe qytetarë,

Ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë seancë solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës të thirrur me rastin e shënimit të 15-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mirupafshim!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë